

### Neni 1

#### Lënda e Kodit

Lëndë e këtij Kodi është zgjerimi i standarteve të detyrueshme të sjelljes së funksionerëve si dhe informimi i qytetarëve, mediave, bashkësisë së biznesit, sektorit civil, si dhe të palëve të tjera të interesuara për standartet e sjelljes që funksionerët kanë si obligim t'i respektojnë.

### Neni 2

#### Domethënia e shprehjeve të përdorura në Kod

Shprehjet në këtë Kod kanë këtë domethënie:

- *funksioner lokal* (në tekstin në vijim: *funksioner*) nënkupton çdo person të zgjedhur ose të emëruar në komunat ose qytetin e Shkupit, si dhe në ndërmarrjet publike, institucionet dhe organizatat e tjera të formuara nga ata;
- *vetëqeverisja lokale* nënkupton të gjitha komunat e Republikës së Maqedonisë dhe qytetin e Shkupit;
- *detyrë* nënkupton kompetencat që rrjedhin nga pozicioni i zgjedhur ose i emëruar, si dhe të gjitha veprimtaritë që ushtron funksioneri në përputhje me këto kompetenca.

### Neni 3

#### Respektimi i ligjeve dhe akteve të vetëqeverisjes lokale

Funksioneri e ushtron detyrën në përputhje me ligjin, aktet e vetëqeverisjes lokale, Kodin Etik dhe të gjitha rregullat e tjera që përcaktojnë detyrimin e tij dhe çdo procedurë të tij e përshat plotësisht me to.

## **Neni 4**

Prioritet interesit publik dhe mbrojtjes së tij  
Gjatë ushtrimit të detyrës, funksioneri i shërben vetëm interesit publik, dhe jo interesave të tij personale direkte apo indirekte, interesave të personave të veçantë ose grupeve personash apo interesave të partive politike.

## **Neni 5**

### **Përgjegjësi dhe dhënie llogarie përpara qytetarëve**

Funksioneri është zgjedhur nga qytetarët e bashkësisë lokale ose është emëruar në emër të tyre dhe përse i përket ushtrimit të detyrës para së gjithash dhe më shumë është përgjegjës para tyre, përfshirë këtu edhe qytetarët që nuk kanë votuar për të apo për listën e tij të kandidatëve.

## **Neni 6**

### **Mbrojtja e imazhit të vetëqeverisjes lokale**

Gjatë ushtrimit të detyrës dhe në jetën private, gjatë kohëzgjatjes së mandatit funksioneri e ushtron detyrën e tij në mënyrë që nuk do ta dëmtojë imazhin e tij, imazhin e administratës së vetëqeverisjes lokale apo vetëqeverisjes lokale në përgjithësi.

## **Neni 7**

### **Mbrojtja e pasurisë dhe e mjeteve të vetëqeverisjes lokale**

Funksioneri është i vetëdijshëm se pasuria dhe mjetet me të cilat ai disponon dhe për të cilat ai vendos gjatë ushtrimit të detyrës, janë të qytetarëve dhe të vetëqeverisjes lokale dhe ndaj tyre ai sillet me përgjegjësi të madhe dhe kujdeset që të mbrohen nga keqpërdorime.

## **Neni 8**

### **Përmbushja e premtimeve dhe e programit zgjedhor**

Funksioneri e fiton mandatin në bazë të programit zgjedhor dhe obligimeve dhe gjatë ushtrimit të detyrës u përmbahet atyre, duke u munduar që me përmbushjen e tyre ta përmirësojë jetesën e qytetarëve të bashkësisë lokale në përgjithësi.

## **KAPITULLI III – OBLIGIME KONKRETE**

### **Kreu 1**

#### **Para marrjes së detyrës**

## **Neni 9**

### **Sjellja në fushatat zgjedhore**

Funksioneri merr pjesë në fushatë zgjedhore vetëm me kundërshtime të argumentuara të programeve, dhe jo me shpifje për kandidatët e tjerë, për partitë e tjera politike apo politikanë, për individë të tjerë, duke përdorur dhunë dhe/ose kërcënime, duke korruptuar apo duke dhënë ose premtuar shërbime.

## **Neni 10**

### **Financimi i fushatave zgjedhore**

Duke qenë i vetëdijshëm përsa i përket financimit të fushatave zgjedhore, funksioneri nuk do të pajtohet me shfrytëzimin e mjeteve financiare të buxhetit ose mjeteve financiare të fondeve publike e të ndërmarrjeve publike për çdo qoftë fushatë zgjedhore, dhe as nuk do të kërkojë për të apo nuk do të pranojë mjete financiare nga burime të paligjshme.

### Neni 11

#### Heqja dorë nga keqpërdorimi i detyrës

Funksioneri, i vetëdijshëm për obligimet që rrjedhin nga ligjet dhe rregullat e vetëqeverisjes lokale, në ushtrimin e detyrës, asnjë procedurë ose veprimtari të tij nuk do ta orientojë në keqpërdorimin e pozitës zyrtare.

### Neni 12

#### Parandalimi i sjelljes korruptuese

Gjatë ushtrimit të detyrës, funksioneri është i obliguar t'i kundërvihet çdo sjelljeje që, në përputhje me ligjet, cilësohet si korruptim aktiv ose pasiv apo t'i sigurojë favore ndonjë personi ose subjekti.

Në rast dyshimi për atë nëse është përcaktuar ndonjë sjellje korruptive, funksioneri procedon në bazë të ligjeve dhe mund t'i drejtohet për opinion institucioneve kundër korrupsionit dhe organeve të caktuara për zbatimin e ligjit dhe vepron në bazë të rekomandimeve të marra nga ato.

### Neni 13

#### Parandalimi i konfliktit të interesave

Kur gjatë ushtrimit të detyrës funksioneri gjendet në situatë që të vendosë për çështje në të cilën ka edhe interes personal ose ndonjë lloj tjetër interesi përveç atij publik, gjithmonë dhe patjetër mbron interesin publik.

Nëse funksioneri ka interes të tij në çështje në vendimin e të cilës merr pjesë, këtë gjë do t'ia parashtojë trupit që vendos për çështjen para se të fillojë procedura lidhur me të, do të kërkojë përjashtimin e tij përse i përket marrjes së vendimit për çështjen dhe në asnjë lloj mënyre nuk do të ndikojë mbi ata që vendosin për të.

## **Neni 14**

### **Kufizimi i ushtrimit të njëkohësishëm të dy ose më shumë funksionesh**

Funksioneri nuk mundet në të njëjtën kohë të ushtrojë më shumë se një detyrë shtetërore apo lokale, të zgjedhur apo të emëruar, si dhe nuk mund të jetë në ndonjë pozicion tjetër që mund ta pengojë ose largojë nga ushtrimi i detyrës së tij në vetëqeverisjen lokale.

Veçanërisht nuk mund të gjendet në pozitë e të ushtrojë mbikqyrje të detyrimeve të veta në vetëqeverisjen lokale, dhe nuk mundet as të jetë i angazhuar në veprimtari nga të cilat rrjedh konflikt i dukshëm apo i patjetërsueshëm interesash.

## **Neni 15**

### **Zbatimi i autorizimeve diskrete**

Autorizimet diskrete shfrytëzohen me përjashtime dhe në përputhje me ligjet dhe aktet e vetëqeverisjes lokale, ndërsa funksioneri që merr një vendim të tillë është i obliguar të ketë, dhe nëse kërkohet të japë, shpjegim të detajuar lidhur me bazat dhe arsyet për një vendim të tillë.

## **Neni 16**

### **Kufizime në dhënien dhe pranimin e dhuratave**

Funksioneri nuk kërkon, nuk pranon, e as nuk lejon ndonjë tjetër në emër të tij të pranojë ose të japë dhurata, shërbime, mikpritje apo ndonjë përfitim personal lidhur me ushtrimin e detyrës, përveç rasteve kur shprehet falenderim me një vlerë simbolike, shuma e të cilës është e rregulluar me ligj ose me akt të vetëqeverisjes lokale.

## **Neni 17**

**Respektimi i disiplinës buxhetare e financiare**  
Funksioneri sillet në mënyrë të përgjegjeshme ndaj buxhetit të vetëqeverisjes lokale dhe ndihmës së huaj, veçanërisht ndaj obligimit të komunës jashtë llogarive të parashikuara të buxhetit dhe si rrjedhojë u përmbahet akteve që rregullojnë funksionimin financiar.

### **Kreu 3**

## **Pas largimit nga detyra**

## **Neni 18**

**Kufizimi i favoreve pas largimit nga detyra**  
Pas largimit nga detyra, funksioneri nuk angazhohet nëpër firmat private mbi të cilat, gjatë mandatit, ka ushtruar kontroll apo ka realizuar ndonjë raport të kontraktuar.

## **KAPITULLI IV – MËNYRAT E MBIKQYRJES**

### **Kreu 1**

## **Gjatë marrjes së detyrës**

## **Neni 19**

### **Verifikimi i burimeve dhe i shpenzimeve të fushatës**

Funksioneri në asnjë mënyrë nuk do t'i pengojë masat dhe veprimtaritë që janë në përputhje me ligjin ose me aktet e vetëqeverisjes lokale, të cilat konsistojnë në verifikimin e burimeve të financimit të fushatës së tij dhe në verifikimin e shumës së shpenzuar për të.

## Kreu 2 Gjatë ushtrimit të detyrës

### Neni 20

#### Deklarimi i interesave

Funksioneri si rrjedhojë i respekton rregullat për deklarimin e gjendjes së pasurisë, interesave personale e familjare.

### Neni 21

#### Përmbajtja ndaj rregullave të brendshme e të jashtme të mbikqyrjes

Funksioneri në asnjë mënyrë nuk do t'i pengojë masat dhe veprimtaritë që janë në përputhje me ligjin ose me aktet e vetëqeverisjes lokale, të cilat konsistojnë në mbikqyrjen e punës së tij.

### Neni 22

#### Obligimi për denoncimin e kërkesave dhe sjelljeve korruptive

Nëse funksioneri është në dijeni të ndonjë sjelljeje korruptive apo jo etike në vetëqeverisjen lokale, është i obliguar ta denoncojë atë menjëherë institucioneve për parandalimin e korrupsionit dhe organeve të përndjekjes.

### Neni 23

#### Mbrojtja e paralajmëruesëve

Funksioneri i respekton dhe i mbron funksionerët ose të punësuarit e tjerë në administratën e vetëqeverisjes lokale të cilët, për shkak të ruajtjes së interesit publik, paralajmërojnë sjellje korruptive ose jo etike në vetëqeverisjen lokale.

## KAPITULLI V – RAPORTET ME OPINION PUBLIK

### Neni 24

#### Publikim në sjelljen e vendimeve

Funksioneri është i obliguar të japë arsye të detajuara lidhur me vendimet dhe hapat që merr, përveç atyre që me ligj janë shpallur si të besueshme, dhe sidomos t'i kushtojë vëmendje të veçantë faktorëve që vërtetojnë se hapa të tillë janë në përputhje me ligjet dhe se janë me interes publik.

## KAPITULLI VI – RAPORTET ME TË PUNËSUARIT NË VETËQEVERISJEN LOKALE

### Neni 25

#### Punësimi dhe ngritja në detyrë në vetëqeverisjen lokale

Funksioneri përpiqet të parandalojë punësimin dhe ngritjen në detyrë në administratën e vetëqeverisjes lokale mbi çdo lloj baze e principesh përveç principeve të profesionalizmit, kompetencës dhe rezultateve pozitive të treguara gjatë punës.

### Neni 26

#### Respekti ndaj të punësuarëve në organet lokale të pushtetit

Funksioneri i respekton dhe sillet me respekt ndaj të punësuarëve në administratën e vetëqeverisjes lokale, pa dallim të përkatësisë apo bindjes etnike, fetare apo politike dhe nga ata nuk kërkon që të sillen në mënyrë të paligjshme, korruptive apo jo etike.



## Neni 27

### Përparimi i punës në vetëqeverisjen lokale

Në kuadër të detyrës së tij, funksioneri përpiqet për përmirësimin e kushteve të punës, për motivimin dhe dhënien e llogarisë së administratës së vetëqeverisjes lokale, veçanërisht për sigurimin efikas e efektiv të kushteve të qytetarëve.

## KAPITULLI VII – RAPORTET ME MEDIAT

## Neni 28

### Transparencë aktive dhe proporcionale

Funksioneri i përgjigjet me hollësi, sinqerisht dhe plotësisht çdo kërkesë nga ana e mediave që ka të bëjë me informacione lidhur me ushtrimin e detyrës së tij, por nuk do të japë informacione të besueshme apo informacione lidhur me jetën private të funksionerëve ose personave të tretë.

Funksioneri i nxit dhe i promovon masat që shërbejnë për përmirësimin e masave për mbulimin e mediave lidhur me autorizimet e tij, me përmbushjen e obligimeve të tij dhe me funksionimin e shërbimeve e departamenteve që janë nën drejtimin e tij.

Në rast se nuk ka mbulim të mjaftueshëm të mediave lidhur me veprimtaritë e komunës, gjë me të cilën sigurohet informimi i opinionit publik, funksioneri do të ndërmarrë iniciativë programore përkatëse për të siguruar një mbulim të tillë.

### **Neni 29**

#### **Mbështetje për zbatimin e Kodit Etik**

Funksioneri i respekton mediat, bashkësinë e biznesit dhe sektorin civil dhe kërkon mbështetje aktive nga ato në nxitjen e vetëdijes lidhur me domosdoshmërinë e përdorimit të sjelljes etike.

### **Neni 30**

#### **Pranimi i Kodit Etik nga funksionerët**

Para marrjes së detyrës, funksioneri vërteton me shkrim se i ka kuptuar dhe i pranon obligimet e këtij Kodi dhe se do të sillët në përputhje me ato, gjë që është kusht jorformal për marrjen e detyrës dhe nisjen e ushtrimit të saj.

### **Neni 31**

#### **Pranimi i Kodit Etik nga ana kandidatëve në zgjedhje**

Si vërtetim i qëllimit se do të sillen në mënyrë etike dhe të përgjegjëshme nëse zgjidhen apo emërohen, kandidatët për funksionerë në vetëqeverisjen lokale mund ta pranojnë me shkrim këtë Kod.

### **Neni 32**

#### **Publikimi i Kodit Etik**

Në kuadër të mundësive, vetëqeverisja lokale merr masa për shpërndarjen sa më të gjerë të Kodit me qëllim që me të të njihen të gjithë të punësuarit në vetëqeverisjen lokale dhe një numër sa më i madh qytetarësh, mediash e organizatash joqeveritare.

### **Neni 33**

#### **Ndjekja e zbatimit të Kodit në nivel të vetëqeverisjes lokale**

Këshilli i vetëqeverisjes lokale mund të formojë një trup për të ndjekur respektimin e këtij Kodi, i cili mund tu japë sqarime funksionerëve, qytetarëve dhe mediave lidhur me thelbin – domethënien e Kodit, si dhe sqarime mbi detajet rreth zbatimit të tij.

### **Neni 34**

**Ndjekja e zbatimit të Kodit në nivel shtetëror**  
Me pranimin e këtij Kodi, funksioneri pranon edhe kompetencën për ndjekjen e respektimit të tij nga ana e trupit në nivel shtetëror, i cili mund të formohet ose miratohet nga Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale.

